



Në bazë të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-0276321/18 dt. 20.11.2018, të investitorit N.N. “Nartel Ex-In” Sh.P.K nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesës administrative, me etazhitet -3B+P+8, në rrugën “Labëria”, Blloku B4, objekti numër 7, Lagjja “Kalabri” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 17.12.2018 lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit** pronarit Pleurat Gjata nga Prishtina, me investitorin N.N. “Nartel Ex-In” Sh.P.K. nga Prishtina me përfaqësues Sami Mehmeti, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-0276321/18 dt. 20.11.2018, për përdorimin e ndërtesës administrative-objekti nr. 7, me etazhitet -3B+P+8, e ndërtuar në kuadër të parcelës kadastrale nr. P-71914059-07604-14, Zona Kadastrale Prishtinë sipas Vendimit 05 nr.351-262399 dt. 14.04.2016 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës, Vendim mbi plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 05 Nr.351-262399 dt. 08.06.2016 dhe konkluzionit 05 Nr. 351-262399 dt. 09.06.2017.

**II.** Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-262399 dt. 14.04.2016, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

**III.** Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

**IV.** Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Pronari Pleurat Gjata me investitorin N.N. “Nartel Ex-In” Sh.P.K. nga Prishtina me përfaqësues Sami Mehmeti, më kërkesën me 09 Nr. 391/02-0276321/18 dt. 20.11.2018, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesës administrative, me etazhitet -3B+P+8, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Vendim nr. 05 Nr. 351-262399 dt. 14.04.2016 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës nr. 7 me etazhitet -3B+P+7 të pronarit Pleurat Gjata me investitor N.N. “Nartel Ex-In” Sh.P.K. me përfaqësues Sami Mehmeti në kuadër të kompleksit të ndërtesave shumë banesore sipas zgjidhjes urbane, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 7604-14 e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-07604-14 ZK. Prishtinë.
- Konkluzionin nr. 05-350-107883 dt. 18.08.2016 mbi ndryshimin dhe plotësimin e kushteve ndërtimore nr 05-350-107883 dhe nr 05-350-107883/1 dt. 01.07.2015 të caktuara në emër të pronarëve Zijadin, Adem dhe Idriz Havolli, Pleurat Gjata, Ali Hajdini, Bashkim Jetullahu, Shaip Muçiqi, Veli Raçi, Destan Morina, Fahri dhe Avni Humolli, me investitor “Nartel Ex-In F&A” sh.p.k. për ndërtimin e objekteve “4”, “5”, “7” dhe rindërtimin-mbindërtimin e objektit “2”, në

kompleksin e objekteve shumë banesore me afarizëm në kuadër të bllokut urban "B4" të tërësisë urbane "B" të Planit Rregullues Kalabria në Prishtinë.

- Vendim 05 Nr.351-262399 dt. 08.06.2018 mbi plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 05 Nr.351-262399 dt. 08.06.2016 dhe konkluzionit 05 Nr. 351-262399 dt. 09.06.2017.
- Dispozita Urbanistike me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Konkluzionin nr. 05 Nr. 351-262399 dt. 09.06.2017 mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 05 nr. 351-262399 dt.14.04.2016. në emër të pronarit Pleurat Gjata nga Prishtina dhe investitorit "Nartel Exin" sh.p.k. nga Prishtina me përfaqësues Sami Mehmeti.
- Aktvendimin numër 05-351-262399 dt.29.03.2016, mbi caktimin e taksës Administrative për lejen e ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Konkluzionin nr. 05 Nr. 351-262399 dt. 09.06.2017 mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 05 nr. 351-262399 dt.14.04.2016. në emër të pronarit Pleurat Gjata nga Prishtina dhe investitorit "Nartel Exin" sh.p.k. nga Prishtina me përfaqësues Sami Mehmeti.
- Konkluzionin nr. 05 Nr. 351-262399 dt. 01.06.2017 mbi ndryshimin dhe plotësimin e aktvendimit nr. 05 nr. 351-262399 dt.29.03.2016. të pronarit Pleurat Gjata nga Prishtina dhe investitorit "Nartel Exin" sh.p.k. nga Prishtina me përfaqësues Sami Mehmeti.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Konstatim mbi caktimin e pikave me nr. të referencës 05-394-89765 dt.25.04.2016
- Informim mbi caktimin e adresës për objektin me nr. të referencës 05-015/02-012500/18 dt. 30.05.2018
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtës,
  - Fadil Vrtopi TN. udhëheqës i vend ndërtimit,
  - Besnik Krasniqi IDA. mbikëqyrës për arkitekturë,
  - Kreshnik Shehu IND. mbikëqyrës për Strukturë,
  - Agron Nagavci IDH. mbikëqyrës për Hidro-Instalime,
  - Nexhmedin Durmishi, IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike,
  - Rifat Lutolli, IDM. Mbikëqyrës për Instalime makinerike,
  - Shaban Halili, mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri,
  - Hajredin Tytyri IDM. Certifikim të ashensorëve.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Dëshmi se të gjitha pagesat janë bërë,
- Protokollet e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Njëkohësisht nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit përmes shkresës nr. 05 Nr.391/02-0146901/18 dt 216.11.2018 ka arritur ne Drejtori: Formulari i Inspektimit Final sipas UA. 05/2017i plotësuar nga Drejtoria përkatëse, Raporti Final i inspektorëve, njoftim për punët e kryera në objekt si dhe foto të objektit të realizuar.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të Inspektimit Final të Inspektionit të ndërtimit të ndërtesës dhe pas plotësimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes shkresës 09 Nr. 391/02-00146901/18 dt. 20.06.2018, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, mbrojtje nga zjarri dhe punëve zeytare,



konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05Nr.351-262399 dt.14.04.2016, si dhe plotësimeve ta aprovuara nga Drejtoria e Urbanizmit. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa administrative mund të përdoret.

Në Raportin e Inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspektionit të Ndërtimit.

**Kërkesat e Vendimit 05 Nr. 351-262399 të datës 14.04.2016 janë zbatuar,**

**Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,**

**Masat për kursim të energjisë janë ndërmarrë.**

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa administrative, me etazhitet -3B+P+8, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-0276321/18 DT. 17.12.2018**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit:

Lindita Beqiri



Drejtori:

Ardian Olluri

